




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 20

Datë 24.04. 2020

KONTRATË PROKURIMI Nr 12

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe
N.SH.H „ZONA PARK” me seli në Prizren me Nr biznesi 70786214 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"),
ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

FURNIZIM ME NJË PORTË DEZINFEKTUESE me numër identifikues 62500.20.033.136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **FURNIZIM ME NJË PORTË DEZINFEKTUESE**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen **FURNIZIMIT ME NJË PORTË DEZINFEKTUESE**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimit do të jetë : QKMF „Dr Shpetim Robaj” Malishevë .

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042 dhe ligji Nr 05/068. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 ÇMIMI

3.1 Çmimi total i kontratës është : 4,750.00€ (me shkronja) :
(katërmijëeshtatëqindëpesëdhjetëeuro) Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetra pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i pranë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3 Menaxhimi i Kontratës

Menaxhimin e Kontratës do ta bëjë zyrtari i QKMF-së z.Urim Thaci i caktuar nga ZKA i AK.

Neni 3.4.Obligimet e OE

OE është i obliguar që furnizimin me Portë dezinfektuese ta kryej në përputhshmëri të plotë me specifikacionin e ofertës.

Furnizimi me portë dezinfektuese duhet të kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK. Nëse furnizimi me portë dezinfektuese nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhshmëri me specifikacionin e ofertës shpenzimet e bera biejnë në llogari të operatorit ekonomik. OE nuk do të i pranohet edhe furnizimet e kryera pa porosi të AK. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë (OE) për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë.

Neni 3.5 AFATI

Furnizimi me me portë dezinfektuese do të kryhet brenda pesë (5) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4 PAGESA

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranohet raportin e kryerjes të furnizimit me portë dezinfektuese nga zyrtari përkatës dhe faturën nga kontraktuesi (OE) t'a paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të caktuar nga ZKA i AK për menaxhim të kontratës).

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha furnizimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në cilë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, nasë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, bëhet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk ëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dëshmon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmas një

gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykmaji që ka fuqinë e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë përparisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës mashore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës mëqënë për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifikat gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Besnik Hoti
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.09/20	Data:	24/04/2020
Vula:		Vula:	

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE LOCALE

SPECIFIKACIONI PËR NJË PORTË DEZINFEKTUESE

NR	PERSHKRIMI	NR SHIFRA MATERIAL	S/SH	PRIME	SH. TOTAL
1	Kabinë dezinfektuese me system të aktivizimit automatic dhe bidon të mbushur me preparat kunder koronavirusit COVID-19, përbërja : contains 633.42 ^g /l, ethanol 81% v/v, 499.90/l ^g , biphenyl-02 --i-on vit-E. Diemzioni i kabines 200cm x160cm.	CO2-1	1	1750,00 €	1750,00 €
TOTALI					1750,00 €